

**NE JEMI TË
RËNDËSISHËM**

LIGJI DHE DEMOKRACIA

ALMIS (10), LEDION (10), YLLI (11), YLLKA (10), LORETA (10), VALTON (11)



E drejta e shkollimit është e barabartë për të gjithë pa dallim gjinie

Sot ne do të tregojmë gjëra për demokracinë

Demokracia rrjedh prej gjuhës greke që do të thotë „demos“ - popull dhe „kratos“ - pushtet. Pra, pushtetin e ka në dorë populli. Për herë të parë demokracia u paraqit në vitin 507 para erës sonë në Athinë, në shtetin e Greqisë.

Falë demokracisë, ne sot shprehemi lirshëm dhe kemi të drejta të barabarta. Gjithashtu, falë demokracisë shteti ynë është bërë vend më i përparuar dhe më i ditur. Demokracia e ka bërë vendin tonë më të bashkuar, prandaj ne duhet të jemi më të edukuar që të bëjmë


vendin tonë një vend më të ditur.

Kemi gjithashtu edhe elemente të tjera të demokracisë. Si p.sh., të drejtat e popullit, respektimi i të drejtave dhe ligjeve, liria, barazia, paqja, toleranca. Toleranca është një gjë shumë e mirë për të gjithë botën. Ajo do të thotë respekt ndaj njëri-tjetrit. Respekti është një gjë që duhet të kemi çdo kund, si në familje, në shkollë, në qytet, etj.

Paqja do të thotë miqësi dhe dashuri ndaj njëri-tjetrit. Ne duhet të ndihmojmë shtetin tonë dhe demokracinë që të bëhemi shtet më i madh dhe i mirë nga të tjerët.



Elementet e demokracisë



Këtu vendosen votat për përfaqësuesit tanë



Të drejtat e barabarta për të gjithë



Grupi i „Demos-ti“

ROLI I KUVENDIT NË DEMOKRACI

ANTIGONA (10), ARISA (10), AULONA (10), GRAMOS (11), ILIR (10), ALBION (10), ELMA (10)

Ne sot mësuam për ligjet e demokracisë dhe mësuam për Kuvendin si institucion i rëndësishëm në demokraci

Ne të gjithë e dijmë se Kuvendi ndryshe njihet me emrin Parlament. Aty bëhet miratimi ose jo miratimi i ligjeve nga deputetët, si dhe zgjedhen Presidenti, Kryeministri apo Qeveria. Duke diskutuar në grup kuptuam se fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke, nga dy fjalët greke siç janë „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje. Në Kuvend janë gjithsej 120 deputetë, por 100 nga ata janë qytetarë shumicë dhe 20 të tjerë janë deputetët e komuniteteve jo shumicë. Kuvendi ka tri funksione, dhe ato janë: përfaqëson popullin, kontrollon Qeverinë dhe miraton ligjet.

Pra, në demokraci ka ligje të cilat janë rregulla që po ashtu shqyrtohen nga Kuvendi. Aty kanë të drejtë edhe deputetët të propozojnë ligje të reja. Faleminderit që e lexuat artikullin tonë!



Ne jemi gazetarët, të cilët e shkruam këtë artikull



Flamuri i Republikës së Kosovës



Bashkëpunimi i grupit tonë



Objekti i Kuvendit të Kosovës



Deputetët të cilët debatojnë

NE QYTETARËT E KOSOVËS

VALON (11), ARBRESHA (10), REMZI (10), LORENA (11), MËRGIMI (11), DJELLZA (10)



Të drejtat dhe përgjegjësitë tona si qytetarë të demokracisë

Ne e dimë që çdo qytetar është pjesë e një kombi, e një familje dhe një shteti ku jeton. Me punë vullnetare njerëzit ndihmojnë shumë njerëz. P.sh. E Shenjta Nëna Terezë me punë vullnetare ka ndihmuar shumë njerëz jetimë, jo vetëm shqiptarë, por në të gjithë botën. Ajo ka qenë zemërgjerë, për të gjithë popullin shqiptar dhe gjithë globin. Përgjegjësitë tona përfshijnë edhe ndihmën ndaj njerëzve nga vetë dëshira jonë.

Me fjalën demokraci kuptojmë qeverisjen e popullit, aty ku çfarëdo vendimi që merr populli, ashtu do të bëhet. Ne dimë se çdo njeri ka të drejtën e të shprehurit lirshëm të çdo fjale, deri sa nuk e pengon tjetrin. Në të kaluarën, njerëzit, përfshirë edhe fëmijët nuk kanë pasur të drejtën e të shprehurit lirshëm, dhe në atë kohë njerëzit nuk kanë pasur të drejtën e lëvizjes së lirë, e as të drejtën e arsimit. Në shkollën tonë, kur hyjmë në klasë duhet të pastrojmë klasën duke i hedhur mbeturinat në vend të caktuar, dhe t'i respektojmë njerëzit dhe rregullat e shkollës.

Mesazhi ynë është që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë dhe të gjithë të jenë të lidhur me njëri-tjetrin, duke ndihmuar, respektuar dhe duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin. Ne shpresojmë dhe besojmë në shtetin tonë, dhe ftojme që secili prej nesh të kontribuojë me forcat e tij.



Të drejtat pa dallime



Ne jemi shembull i qytetarëve aktiv

POPULLI VENDOS PËR TË ARDHMEN

ARTIOLA (11), ARDONITA (10), SARA (10), ARDITI (10), SHUAJB (11), EDONIS (10), IDEAL (10)


Nga ne do të mësoni se pse zgjedhjet janë proces i rëndësishëm për popullin

Zgjedhjet janë proces i rëndësishëm, sepse populli ka të drejtën të votojë lirshëm për personat që mendon se do ta përfaqësojnë më së miri vendin. Ne e përdorim procesin e votimit edhe në klasë, sepse aty e zgjedhim kryetarin e klasës. Por, për zgjedhjet e vendit kemi të drejtë të votojmë nga moshja 18 vjeçare, kur edhe jemi më të pjekur. Përmes votimit, populli vendos për të ardhmen e shtetit të vet. Edhe deputetët e zgjedhur, edhe pjesa tjetër e popullit duhet t'i zbatojnë parimet e demokracisë, siç janë: liria, paqja, barazia, respekti, zgjedhjet, drejtësia, solidariteti etj.


Janë dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore, ku zgjedhen deputetët dhe zgjedhjet lokale, ku zgjedhen kryetarët e komunave përkatëse. Në Kuvendin tonë kemi 120 deputetë të cilët na përfaqësojnë ne, prandaj është e rëndësishme që të gjithë të dalim në zgjedhje, dhe të vendosim për të ardhmen e popullit tonë.




Gazetarët e demokracisë



Vota jonë ka rëndësi



Voto edhe ti për të ardhmen e popullit tënd



Të gjithë së bashku për ndryshim



Ne duam të jetojmë më një shtet demokratik



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hilmi Rakovica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-4
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë